

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronjat g), m), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neneve, 14 dhe 19 paragrafët 1.7 dhe 1.13 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 6.22 të Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale nr.prot.01-431/04-0014941/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në kuadër të masave për parandalimin dhe luftimin e Corona virusit COVID-19 si formë e mbështetjes për qytetarët dhe subjektet afariste në territorin e Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 02 prill 2020, miratoi këtë;

### **VENDIM**

#### **PËR LIRIMIN NGA TAKSA KOMUNALE TË GJITHA SUBJEKTET AFARISTE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2020**

##### **Neni 1**

Me këtë Vendim, lirohen nga taksa komunale të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës, për vitin 2020.

##### **Neni 2**

Lirimi nga taksa sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të mbështetjes së subjekteve afariste për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Corona Virus COVID-19.


##### **Neni 3**

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoritë e Administratës komunale, varësisht fushveprimtarisë dhe kompetencave përkatëse.

##### **Neni 4**

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Nr.01-016/01-0020194/20**  
**Podujevë,**  
**02 prill 2020**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**